



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës

Tel/Fax: +355 4 2380 300/323
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202300111/2

Tiranë ___/___/2023

Lënda: *Rekomandime për inspektimin e bërë në Komisaratin e Policisë nr. 5 Kamëz, Tiranë.*

Drejtuar: **z. Muhamet RRUMBULLAKU**
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

z. Tonin VOCAJ
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë

TIRANË

z. Oliger TORBA
Shef i Komisariatit të Policisë nr.5 Kamëz

TIRANË

Të nderuar,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm midis institucioneve tona, si dhe duke vlerësuar angazhimin për punën e stafit të institucionit që ju drejtoni, në vijim po ju njohim me gjetjet dhe rekomandimet nga inspektimi i kryer në ambientet e privimit të lirisë së personit në Komisaratin e Policisë nr.5 Kamëz nga Institucioni i Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në Komisaratin e Policisë nr.5 Kamëz, në datën 02.02.2023, sipas një Plani Inspektimi vjetor të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Hazbi Selita dhe z. Besnik Deda me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi i inspektimit ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave themelore të të shoqëruarve, të cilat ju garantohen me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Procedurës Penale, ligjin nr.108/2014 "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, si dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore të personave të privuar nga liria.

Gjithashtu, qëllimi i inspektimit ishte verifikimi i respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin dhe ligjor t’ju parashtrorë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi inspektues u takua me shefin e komisariatit z. Oliger Torba, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim të takimit, z. Torba informoi grupin e inspektimit, mbi masat e marra për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit, referuar inspektimit të mëparshëm lidhur me përmirësimin e kushteve të ambienteve të shoqërimit dhe të sigurisë së këtij komisariati, sipas procedurave standarde dhe për rritjen e performancës së punonjësve të policisë për respektimin e të drejtave ligjore të shtetasve të shoqëruar, arrestuar/ndaluar.

Grupi inspektues, pasi mori informacionin e nevojshëm lidhur me qëllimin e inspektimit, vijoi takimin me punonjësit e policisë të zyrës së informacionit, të dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë. Theksojmë se, shefi i komisariatit dhe punonjësit e policisë u treguan bashkëpunues dhe transparentë gjatë komunikimit dhe inspektimit që zhvilloi grupi inspektues në ambientet e këtij komisariati.

Në vijim, grupi i punës inspektoi ambientet e shoqërimit, disa zyra të punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar. Gjatë inspektimit të zyrave të punonjësve të Komisarariatit të Policisë nr.5 Kamëz, nuk u konstatuan sende apo mjete të cilat mund të ekspozonin dhunë apo elemente për trajtim çnjerëzor dhe denigruës.

Nga informacioni i grumbulluar në vend gjatë kryerjes së inspektimit, rezultoi se gjendja faktike e ambientit të shoqërimit thuhet e njëjtë si në inspektimin pararendës, ballafaquar me standardet e parashikuara në aktet normative dhe dokumentet ndërkombëtare për respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, brenda këtyre ambienteve.

Nga verifikimi i masave për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, rezultoi se:

1. **Ishte zbatuar rekomandimi**, për ndërtimin e ambienteve të sigurisë sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me urdhrin nr.925, datë 18.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të ndara më vete për të rritur, femra dhe të mitur. Me fillimin e funksionimit

të “Bllokut të Sigurisë” në Tiranë, kanë gjetur zbatim rekomandimet e bëra nga Institucioni i Avokatit të Popullit për persona të ndaluar/ të arrestuar në të gjitha komisariatet në varësi të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.

2. **Ishte zbatuar rekomandimi**, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në të gjitha mjediset e Komisarariatit të Policisë nr.5 Kamëz, Tiranë.
3. **Ishte zbatuar rekomandimi**, për marrjen e masave të menjëhershme, për dhënien e kartës së të drejtave për personat e shoqëruar, që në momentin e hyrjes në Komisariatin nr.5 Kamëz, Tiranë.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se nuk kishin gjetur zbatim rekomandimet e mëposhtme:

1. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar, në dhomën e intervistimit dhe evidentimin e marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore në zyrat e punës së tyre.
2. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për instalimin e sistemit të ngrohjes me kaldajë në ambientet e shoqërimit të Komisarariatit të Policisë nr.5 Kamëz dhe vënien e tij në funksionim në periudhën e dimrit, sipas urdhrin të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

Në përfundim të inspektimit, grupi monitorues konstatoi, se në Komisariatin e Policisë nr. 5 Kamëz ishin marrë disa masa për përmirësimin e standardeve lidhur me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar, por nisur nga kushtet aktuale vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika, si më poshtë vijon:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Në Komisariatin e Policisë nr. 5 Kamëz, ambienti i shoqërimit ishte i ndërtuar pjesërisht sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, dhe urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, në ambiente me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femra, meshkuj madhorë dhe të mitur¹.

Ambienti i shoqërimit ndodhej në katin e parë të godinës së komisarariatit. Në institucion kishte tre (3) dhoma shoqërimi, të cilat ndaheshin në një (1) dhomë shoqërimi për meshkuj madhorë, një (1) dhomë shoqërimi për gra dhe një (1) dhomë shoqërimi për të mitur, me dimensione 5x4m². Dy nga dhomat ishin me hapësirë të bollshme dhe me dritare, të cilat siguronin ajrim dhe ndriçim të plotë natyral, por kishte ndriçim edhe nga rrjeti elektrik. Gjithashtu, dhomat e shoqërimit ishin të pajisura me orenditë e nevojshme, si karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, por mungonin tavolinat në këto ambiente. Secila dhomë kishte kapacitet deri në 4 persona të shoqëruar në konflikt me ligjin. Sa i përket dhomës së shoqërimit për të miturit në konflikt me ligjin, ajo ndodhej në katin e dytë të këtij institucioni e krijuar nga investimi i realizuar me fondet e World Vision, në

¹ Kreu VI, pika 3/d e procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

partneritet me organizatën “Nisma për Ndryshim Shoqëror-Arsis”, në vitin 2019. Ky investim ka sjellë krijimin e tre dhomave me një hapësirë miqësore për të miturit, dy (2) dhoma paralele të ndara sipas grupmoshës 0-14 vjeç dhe 14-18 vjeç dhe një (1) dhomë ku ndodh ndjekja e procesit të intervistimit dhe regjistrimit për këtë kategori. Dhomat ishin të pajisura me të gjitha orënditë e nevojshme si tavolina, kolltuqe, bibliotekë për libra, postera informues, si dhe ishte e monitoruar me sistemin audio-viziv. Në Komisariatit e Policisë nr.5 Kamëz ishin trajnuar 2 specialistë vetëm për intervistimin apo marrjen në pyetje të të miturve. Dhomat e intervistimit për të mitur ishin funksionale dhe përdorshin për kryerjen e veprimeve procedurale të intervistimit të të miturve në konflikt me ligjin.

MKPT e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se bisedat me fëmijët, realizohen në një ambient të përshtatshëm, i cili është i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave më të miturit, pasi nga intervistimi i tyre në kushte dinjitoze shmangët dhe parandalohet traumatizimi i tyre.

Dy dhomat e shoqërimit për meshkujt madhorë dhe për gratë ishin të pajisura me skara hekuri të montuara në muret e koridoreve. Mjedisi i shoqërimit dhe ambientet e tjera të komisariatit nuk kishin sistem ngrohjeje qendror. **Dhomat nuk ishin të lyera dhe nuk ishin në kushte të mira higjienike.** Dhoma e cila përdorej për të shoqëruar femra ishte e pajisur me tualet brenda, ndërsa për të shoqëruar meshkujt madhorë përdorej tualeti i cili ndodhej në korridorin e ambientit të shoqërimit. Tualetet kishin ujë të rrjedhshëm gjatë 24 orëve, por ato paraqisnin probleme nga ana higjieno-sanitare dhe kishin nevojë për larje, lyerje dhe dezinfektim të herë pas hershëm të tyre.

Sa më lart, në vlerësimin e Avokatit të Popullit, prezenca e skarave të hekurit në mjedisin dhe dhomat e shoqërimit, në pamje të parë përbën për personat e shoqëruar formë presioni psikologjik, trajtim jo dinjitoz të personave që qëndrojnë në këto dhoma dhe shërben si një premisë për kryerjen e vetëvrasjeve të personave të shoqëruar apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë, ndaj ato duhet të hiqen në këto ambiente në përputhje me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë së shtetit”.

Ekzistenca e një elementi shtrëngues në ushtrimin e kompetencave policore të shoqërimit për verifikimin dhe ushtrimin e kontrollit tregon një heqje lirie të personit, pavarësisht qëllimit të shoqërimit dhe se sa e shkurtër është koha e qëndrimit në mjediset e policisë të shtetasve. Në këto kushte, ambientet e shoqërimit në polici duhet të jenë të ndërtuara në proporcion të drejtë me veprimet administrative të kryera nga punonjësit e policisë. Konkretisht dhe në nenin 109 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, thuhet shprehimisht se: *“Personi i shoqëruar **nuk** trajtohet në të njëjtat kushte me personin e ndaluar ose të arrestuar dhe, në çdo rast, shoqërimi duhet të zgjasë deri në sqarimin e çështjes, por jo më shumë se 10 orë”*.

Në dhomat e shoqërimit të këtij komisariati kishin nevojë për lyerje dhe mbajtjen pastër, nga ana higjieno-sanitare, pasi nuk garantojnë standardin sipas Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019 për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”².

² *Kreu VII, pika 4 e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici” ku përcaktohet se: “Mjediset të jenë me sipërfaqe për qëndrimin e personave të jenë të lyera, të pastra nga higjienike si dhe të kenë dritare me përmasa të tilla që të krijojnë mundësi për realizimin e ajrimit e ndriçimit të plotë natyral”.*

Ndërkohë, dhomat e sigurisë ishin të mbyllura me çelës dhe ishin jo funksionale në zbatim të urdhrin të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për mbylljen dhe mos funksionimin e dhomave të sigurisë në Komisarariat e Policisë nr.5 Kamëz, Tiranë”³, si dhe në zbatim të urdhrin të brendshëm të shefit të Komisarariatit të Policisë nr. 5 Kamëz, Tiranë me nr.325 prot, datë 31.03.2022 “Për mbylljen dhe mos funksionimin e dhomave të sigurisë në Komisarariat e Policisë nr. 5 Kamëz, Tiranë”.

Në Komisarariat e Policisë nr.5 Kamëz, gjatë periudhës 01.01.2023 deri më 02.02.2023 ishin të shoqëruar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit **92** persona, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 109 dhe 112/1 të ligjit “Për Policinë e Shteti”, ku saktësisht ishin shoqëruar **83** shtetas madhorë, **2** shtetase gra dhe **7** shtetas të mitur. Në momentin e inspektimit **nuk kishte asnjë shtetas** në dhomat e shoqërimit.

Gjithashtu, grupi i inspektimit u informua se personat e shoqëruar nga policia janë të informuar për të drejtat e tyre, që nga fillimi i privimit të lirisë, duke siguruar informacion të qartë verbal në lidhje me të drejtat ligjore/procedurale që ata kanë, ndonëse nuk ka dokumentim të këtij fakti. Mekanizmi Kombëtar kërkon dhënien e kopjes së kartës së të drejtave të të shoqëruarve që në momentin e hyrjes në komisarariat, për të garantuar njohuritë e nevojshme për të drejtat e tyre.

Nga verifikimi i regjistrin të marrjes dhe dorëzimit të personave të shoqëruar dhe kopjeve të procesverbalit të veprimeve të kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar, në rubrikën me shënimet në lidhje me ankesat/kërkesat e të shoqëruarve rezultoi, se për vitin 2023 nuk kishte asnjë ankesë të regjistruar.

Grupi i inspektimit u informua nga shefi i komisarariatit, se në vitin 2022, me vendimin nr.505, datë 27.07.2022 të Këshillit të Ministrave është miratuar fondi në shumën 128.852.691 lekë “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të objektit të Komisarariatit të Policisë nr.5 Kamëz, Tiranë dhe caktimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit si njësi zbatuese”⁴, por ende Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nuk ka vijuar marrjen e masave për hapjen e procedurës në zbatim të VKM me nr. 505, datë 27.07.2022 të Këshillit të Ministrave.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson vendimin e Këshillit të Ministrave për rikonstruksionin e objektit të Komisarariatit të Policisë nr.5 Kamëz, sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, dhe aktin të procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë së shtetit”, miratuar me urdhrin nr.938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke ndërtuar dhomat e shoqërimit sipas përcaktimeve ligjore në fuqi të ndara më vete për rritur, femra dhe të mitur, dhe mjedise të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim dhe të monitoruara me kamera. Ndërkohë, Institucioni i Avokatit të Popullit i kërkon Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, marrjen e masave për zbatimin e

³ Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit me nr. 2374 prot, datë 29.03.2022 “Për mbylljen e mos funksionimin e dhomave të sigurisë në Komisarariat e Policisë nr.5 Tiranë”.

⁴Në pikën 2 të këtij vendimi thuhet se: “Në buxhetin e miratuar për vitin 2022 për Ministrinë e Brendshme në programin buxhetor “Policia e Shtetit”, 03440, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm” shtohet fondi prej 25.770.538 lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionin e objektit të Komisarariatit të Policisë nr. 5 Kamëz, që do të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë”.

vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 27.07.2022 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të objektit të Komisarariatit të Policisë nr.5 Kamëz”, që ka të bëjë me shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin e personave në mjediset e komisarariatit, si dhe detyrimeve ligjore që kanë punonjësit e policisë për respektimin e garantimin e të drejtave që ju njeh ligji këtyre personave.

Korridori në mjedisin e shoqërimit monitorohej nga sistemi i kamerave, ndërsa zyrat e punonjësve të policisë ku merren në pyetje personat e shoqëruar, nuk ishin të monitoruara me sistemin e kamerave. Administrimi i kamerave kryhej nga specialistët e IT-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Afati për ruajtjen e pamjeve filmike ishte 15 ditë. Për sa më sipër, duhet të merren masa urgjente që hapësirat e sigurisë të shndërrohen në dhomë instervistimi për të garantuar marrjen në pyetje sipas parashikimeve e rregullore në fuqi.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Komisariatin e Policisë nr. 5 Kamëz, Tiranë nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar, në përfundim të veprimeve procedurale nga ana e punonjësve të policisë, dërgoheshin menjëherë në dhomat “Blloku i Sigurisë”, ambient i cili është i ndërtuar sipas kërkesave të parashikuara në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurën standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, miratuar me urdhrin nr.925, datë 18.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. “Blloku i Sigurisë” në Tiranë, është një investim i ri ku mbahen dhe sigurohen personat e arrestuar/ndaluar nga të gjitha komisarariatet e policisë në varësi të DVP-së Tiranë.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre

Në Komisariatin e Policisë nr. 5 Kamëz, Tiranë, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 938, datë 24.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë së Shtetit”.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë, sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se të gjitha rubrikat e tij ishin plotësuar me korrektesë dhe përgjegjësi nga punonjësit e zyrës së informacionit dhe ishte i sekretuar. Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi ishte e ndryshme nga 1 orë deri në 10 orë në raste të veçanta.

Ndërkohë, komisarati kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por për vitin 2023 nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë nga ana e këtyre personave.

Nga inspektimi u konstatua se Komisarati nr. 5 Kamëz, Tiranë ishte pajisur me një regjistër të posaçëm, vetëm për të miturit në konflikt me ligjin. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se të gjitha rubrikat e tij ishin plotësuar me korrektesë dhe përgjegjësi nga punonjësit e zyrës së informacionit dhe ishte i sekretuar.

Ambientet e intervistimit

Në Komisarjatin e Policisë nr.5 Tiranë, nuk ka një dhomë më vete të monitoruar me sistemin e kamerave, që të shërbejë për intervistimin/ marrjen në pyetje të personave të shoqëruar nga punonjësit e policisë, për të cilët ekzistojnë kushtet e përcaktuara në ligj se ka dyshime të arsyeshme që kanë kryer një veprë penale. Në mungesë të kësaj dhome, këta persona merren në pyetje në zyrat e punës të punonjësve të policisë.

Avokati i Popullit e konsideron krijimin e dhomave për marrjen në pyetje dhe procesin e intervistimit të personit, në ambientet e shoqërimit, të cilat duhet të jenë të monitoruara me sistemin e kamerave të sigurisë, si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi monitorimi filmik ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit ndaj tyre⁵.

Lidhur me këto fakte, Institucioni i Avokatit të Popullit i ka rekomanduar në mënyrë të përsëritur, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorive Vendore të Policisë, marrjen e masave për krijimin e zyrave të posaçme, për marrjen në pyetje të shtetasve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, por sikurse konstatohet nga inspektimet periodike të zhvilluara nga MKPT, ky rekomandim ende nuk është plotësuar.

Grupi i monitorimit, inspektoi zyrat e punës së punonjësve të policisë që kryenin veprime procedurale me personat e shoqëruar. Nga monitorimi nuk u gjetën sende prania e të cilave të ekspozonte dhunë ndaj personave me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

Ndërsa për të miturit në konflikt me ligjin mund të përdorin ambientin e veçantë për marrjen në pyetje/intervistim, e krijuar nga investimi i realizuar me fondet e World Vision, në partneritet me organizatën “Nisma për Ndryshim Shoqëror-Arsis”, në vitin 2019.

Institucioni i Avokatit të Popullit kërkon që në planin e rikonstruksionin të objektit në Komisarjatin të Policisë nr.5 Kamëz, të bëhet sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, dhe aktit të procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë së shtetit”, miratuar me urdhrin nr.938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Duke ndërtuar dhomat e shoqërimit sipas përcaktimeve ligjore në fuqi të ndara më vete për rritur, femra dhe të mitur, dhe mjedise të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orëditë e nevojshme për qëndrim dhe të monitoruara me kamera, si dhe krijimin e dhomave për marrjen në pyetje dhe procesin e intervistimit të personit të shoqëruar në konflikt me ligjin, të cilat duhet të jenë të monitoruara me sistemin e kamerave të sigurisë.

Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor

⁵ Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm të standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim. Po ashtu kjo kërkon një regjistër të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje elektrike (audio dhe video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë e bërë nga i ndaluar gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste. CPT raports; Armenia: visit 2010 [par.18]

Në këtë komisariat, punonjësit e policisë zbatonin detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 e procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë, që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Nga inspektimi rezultoi, se për personat e shoqëruar mbahej procesverbali tip “Formulari i raportit të shoqërimit ose ndalimit/arrestimit”. Njëkohësisht, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 34/b, pika 2 dhe 251 të Kodit të Procedurës Penale, që të ndaluarit/arrestuarit duhet t’i jepet një kopje e procesverbalit të ndalimit/arrestimit.

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat të caktuar kryesisht.

Punonjësit e policisë i parashtruan grupit të inspektimit, se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, ndërsa psikologu sigurohej nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë. Gjatë verifikimit të regjistrave të personave të shoqëruar, u konstatua se procedura e ndjekur nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë nr.5 Kamëz ishte zhvilluar konform ligjit.

Në rastet kur të shoqëruarit paraqisnin probleme shëndetësore, punonjësit e policisë i shoqëronin në Qendrën Shëndetësore Kamëz, për të marrë ndihmën mjekësore.

Nga inspektimi në ambientin e shoqërimit në Komisariatin e Policisë nr.5 Tiranë, grupi i inspektimit konstatoi se në dhomat e shoqërimit dhe në korridore ishin të afishuara posterat me të drejtat e personave të shoqëruar, por ato kishin nevojë të rifreskohen me të reja. Gjithashtu, afishimi i të drejtave duhet të bëhet dhe në vende të tjera të aksesueshme nga personat që ndodhen në mjediset e policisë, me qëllim për të dhënë mundësinë e leximit dhe kuptimit të këtyre të drejtave nga ana e tyre.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”.

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për hapjen e procedurës në zbatim të VKM-së me nr. 505, datë 27.07.2022, e cila parashikon levrimin fondeve në shumën 128.852.691 lekë “Për rindërtimin për financimin dhe rikonstrukcionin e objektit të Komisarariatit të Policisë nr. 5 Kamëz, Tiranë, sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, dhe aktit të procedurave standarde “Rregullat

teknike të shoqërimit në mjediset e policisë së shtetit”, miratuar me urdhrin nr.938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke ndërtuar dhomat e shoqërimit sipas përcaktimeve ligjore fuqi të ndara më vete për meshkuj madhorë, femra dhe të mitur, si dhe mjedise të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrimin e personave të shoqëruar dhe të monitoruara me kamera.

2. Marrjen e masave të menjëhershme, për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar në dhomën e intervistimit dhe evidentimin e marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore në zyrat e punës së tyre.
3. Marrjen e masave të nevojshme, për instalimin e sistemit të ngrohjes me kaldajë në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë të Komisarariatit të Policisë nr.5 Kamëz dhe vënien e tij në funksionim në periudhën e dimrit, sipas urdhrin të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit me nr.938, datë 24.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë së Shtetit”.
4. Marrjen e masave të menjëhershme, për pajisjen e dhomave të shoqërimit me orenditë e nevojshme, si tavolinë, karrige për qëndrimin e personave të shoqëruar në konflikt me ligjin.
5. Marrjen e masave të menjëhershme, për mirëmbajtjen e dhomave të shoqërimit, lysterjen e tyre dhe garantimin e kushteve higjiëno-sanitare të tualetit dhe të ambienteve të tjera të Komisarariatit të Policisë nr.5 Tiranë.
6. Marrjen e masave të menjëhershme, për dyllosjen e dhomave të sigurisë në këtë komisarariat, sipas procedurës standarde “*Trajtimi dhe siguri i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, miratuar me urdhrin nr.925, datë 18.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
7. Marrjen e masave të menjëhershme, për heqjen e skarave të hekurit në korridorin e dhomave të shoqërimit, pasi përbën trajtim jo njerëzor dhe jo dinjitoz të personave që qëndrojnë në këto dhoma dhe shërben si një formë presioni psikologjik, dhe si premisë për kryerjen e vetëvrasjeve të personave të shoqëruar apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONER

AHMET PRENÇI